



Datë/a:	15.11.2022
Për/ Za/ To:	Dedë Nikolla
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Nexhmi Mekolli –Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit –Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendimi i kërkesës për ri-shqyrtim

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.11.2022të parashtruar nga **Dedë Nikolla** , për aktivitetin:” **“Sherbime për konsulence për angazhim të 10 eksperteve për menaxhim të projekteve për nevojat e Komunes së Prishtinës”** Nr. të Prok: 616-22-6983-211 ,616 22 103 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Dedë Nikolla, për aktivitetin: **“Sherbime për konsulence për angazhim të 10 eksperteve për menaxhim të projekteve për nevojat e Komunes së Prishtinës”** Nr. të Prok: 616-22-6983-211 ,616 22 103 211 nxjerr: kundër Vendimit të AK-së , të datës 09.11.2022 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të Vendimit të AK-së të datës 09.11.2022.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Dedë Nikolla me datë 10.11.2022 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sherbime per konsulence per angazhim te 10 eksperteve per menaxhim te projekteve per nevojat e Komunes se Prishtines”** Nr. të Prok: 616-22-6983-211 ,616 22 103 211

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Dedë Nikolla .

Pretendimet ankimore te parashtruara nga ana juaj jane krejtesisht te paqendrueshme pasi qe kerkese E AK ka qene qe **personi fizik duhet të jetë i pajisur me letërnjoftim valid** ndërsa ju keni dorëzuar letërnjoftimin me afat te skaduar qe nga data 12.12.2018 . Nuk keni respektuar dispozitat e nenit 7.1 dhe 7.2 T dosjes se tenderit .

Poashtu lidhur me pretendimin tuaj se ju keni dorezuar gjithe pervojen tuaj ne CV duke i bashkangjitur referenca valide te punes nuk e permbush kerkese e AK sic ka qene : inxhinier i diplomuar i ndertimtarise drejtimi Konstruktiv ,infrastruktore rrugore -5 pozita (niveli master ose bachelor) .**Menaxhim , mbikqyrje te projekteve te DIKMK-se.**Duhet te kete min 5 vite pervoje pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv) sepse ne CV-ne tuaj nuk eshte e cekur se ju keni menaxhuar apo mbikqyrur projekte te DIKMK-se si dhe poashtu nuk keni ofruar deshmi –referenca te pervojes se punes per menaxhim ,mbikqyrje te projekteve te DIKMK-se . Ne momentin qe ne CV-ne tuaj nuk eshte cekur se keni menaxhuar apo mbikqyr projekte te DIKMK-se nuk mund te ju kerkohet sqarim shtese lidhur me referencat dhe per kete arsye eshte refuzuar tenderi juaj.

Pretendimi se per marrjen e nje vendimi u eshte dashur me shume kohe sec eshte lejuar me ligj eshte i paqendrushem pasi qe sa per dijeni qe nga data 25 gusht deri me 01.10.2022 ka qene greva e punonjeseve te administrates dhe te arsimit ne mbare vendin si dhe duke marr parasysh kompleksitetin e natyres se aktivitetit te prokurimit Departamenti i Prokurimit ne harmoni me dispozitatat e LPP-se dhe ROUPP-se ka te drejte zgjas afatin per vleresimin e ofertave .

AK duke u mbeshtetur ne parimet e pergjithshme te LPP-se perkatesisht neni7 Barazia ne trajtim/ jo diskriminim qe do te thote se AK do ti trajtoj OE-ik ne menyre te barabarte jo diskriminuese dhe ne menyre transparente .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit.